



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.225/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rufki Suma, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, të paraqitur kundër, mbështetësve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Hani i Elezit, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 17.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.225/2025, e datës 16.10.2025, parashtruar nga Rufki Suma, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, e paraqitur kundër, mbështetësve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Hani i Elezit, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 16.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Rufki Suma, kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Hani i Elezit, e cila është parashtruar me datë 13.10.2025, e dorëzuar në Postën e Kosovës, në të cilën pretendohet se me datë 12.10.2025 donatori i PDK-së Alba Group Sherif Ramuka me babain vëllain dhe djalin e tij bëjnë kërcënime si ndaj punëtorëve të tij, po ashtu edhe joshje me mjete materiale për ta votuar PDK-në dhe kandidatin Mehmet Ballazhi. Parashtruesi i ankesës thekson se donatori Alba group i ka dërguar material ndërtimor Sefedin Ramukes në këmbim të votës. Po ashtu parashtruesi i ankesës thekson se militante të PDK-së gjatë tërë ditës kanë asistuar nga dy herë e më tepër nëpër vendvotime për ti ndihmuar kinse personave që nuk dinë të votojnë, ndërsa në vendvotimin në fshatin Paldenicë 3302-2 një fletëvotim është nxjerrë nga vendvotimi dhe i njëjti është përcjellë disa votuesve që kanë ndikuar në qindra vota, ku i njëjti thekson se kjo mungese e fletëvotimit është konstatuar edhe gjatë numërimit të votave ndërsa në vendvotimin nr. 2 Seçishte në vendvotimin 3304-2 ka pasur të shtëna me armë, dhe deri në përfundimin e

votave militante te PDK-së kane qëndruar ne dritaret e klasës ku behej numërimi i votave duke i bere presion anëtarëve të komisionerëve dhe vëzhguesve. I njëjti thekson se votuesve te tyre nuk i është lejuar te votojnë me arsyetimin se i kane dokumentet me afat te skaduar si dhe disa votuesve jashte Kosovës nuk i kanë shkuar ne adresat e tyre zarfet me fletëvotime, ndërsa disa te cilët kane ardhur per te votuar te njëjtëve nuk i është lejuar qe te votojnë, ndërsa votuesve te PDK-se i është lejuar te votojnë përkundër qe te njëjtit kane votuar jashte Kosovës. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të kthehet në rivotim i gjithë Hani i Elezit pasi që i njëjti thekson se janë shkelur dispozitat ligjore gjate procesit zgjedhor ku shihet se është përdorur treni bullgar Si dëshmi i ka bashkangjitur ankesës foto dhe deklarata.

Në përgjigje në ankesë të subjektit politik PDK thekson se, ankesa e z. Rutki Suma është e pa afatshme sipas ligjit, megjithatë, përveç konstatimit se ankesa është paraqitur jashtë afatit 48 orësh, siç parashihet me ligj. Pretendimet në ankesën e z. Rufki Suma se pronari i kompanisë Alba Group SH.P.K., ka kërcënuar punëtorët e tij për të votuar për kandidatin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), si dhe se në lagjen Ramuka, janë shpërndarë materiale ndërtimi në këmbim të votës. 4. këto pretendime janë krejtësisht të pabazuara dhe nuk mbështeten në asnjë provë, fakt apo dëshmi konkrete. Pavarësisht ashpërsisë së akuzave, ankuesi nuk ka ofruar asnjë dokument, deklaratë apo provë materiale që do të mbështeste këto pohime. Për të sqaruar këtë çështje, Partia Demokratike e Kosovës ka kontaktuar pronarin e kompanisë Alba Group SH.P.K., z. Shemsedin Ramuka, i cili ka dorëzuar një deklaratë zyrtare, përmes së cilës i mohon në tërësi të gjitha pretendimet e paraqitura nga z. Suma. Në deklaratën e tij, z. Ramuka thekson qartë se nuk ka ushtruar presion ndaj askujt, e as nuk ka shpërndarë materiale ndërtimi apo përfitime të tjera në ndonjë formë apo qëllim zgjedhor. 6. Po ashtu, z. Suma pretendon se aktivistë të PDK-së kanë lëvizur në rrugë duke ofruar para në këmbim të votës. Edhe ky pretendim është i pabazuar dhe pa asnjë provë konkrete, Fotot që ankuesi i ka bashkëngjitur ankesës nuk dëshmojnë asnjë veprim të tillë, dhe nuk përmbajnë elemente që mund të lidhen me PDK-në apo me ndonjë prej përfaqësuesve të saj. Në ankesë po ashtu pretendohet lidhur me të ashtuquajturin "tren bullgar". edhe ky pretendim është plotësisht i paargumentuar dhe nuk mbështetet në asnjë fakt apo dëshmi konkrete. Fotografia e bashkëngjitur nga ankuesi nuk ka asnjë vlerë provuese dhe nuk vërteton asnjë veprim të kundërligjshëm. Në përmbledhje, z. Rufki Suma nuk ka arritur të ofrojë asnjë provë të vetme që do të mbështeste ndonjërin nga pretendimet e tij. Ankesa e tij përbëhet vetëm nga konstatime të përgjithshme, të paqarta dhe të pambështetura. Si prova ka bashkangjitur, deklarata e z. Shemsedin Ramuka, Drejtor i Alba Group SH.P.K. Duke i propozuar Panelit që ankesën të refuzoj të pabazuar.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ-në e komunës së Hanit të Elezit duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: KKZ Hani i Elezit nuk ka pasur asnjë ankesë që ka ndikuar apo penguar procesin zgjedhor, Këshilli i vendvotimeve - Kryesuesi nuk ka paraqitur ndonjë ankesë në lidhje me çështjen e asistimit dhe gjithmonë është përgjigjur se gjithçka është duke shkuar në rregull. KKZ Hani i Elezit gjatë gjithë kohës ka qenë në vizita te qendrat dhe ka vërejtur që Këshilli i vendvotimeve - Kryesuesi gjatë shfaqjes së nevojës së asistimit ka vlerësuar me kujdes dhe me përgjegjësi të plotë lejin apo refuzimin e asistimit, me ç ‘rast ka hyrë në debat me çdo votues që i është dashur asistuar për të sqaruar arsyen e asistimit, dhe ka mbajtur shënime në

libër me të dhënat e çdo rasti veçmas. Në lidhje me pretendimet e palës ankuese për kandidatë të caktuar, KKZ në Han të Elezit ka deklaruar përmes përgjigjes se nuk ka pasur parregullsi të raportuara dhe se, po të kishte ato parregullsi do të shënoheshin në librin e votimit. Në QV Paldenicë 3302, në vendvotimin 3302/02, ku pala ankuese ka përmendur trenin Bullgar me pretendimin se ka dalë një fletëvotim jashtë QV dhe është keqpërdorur, në fakt një pretendim i tillë nuk është faktuar dhe nuk kemi asnjë ankesë apo provë që e vërteton keqpërdorimin. Në QV Seqisht (3304) pala ankuese ka pretenduar se gjatë numërimit të fletëvotimeve ka pasur të shtëna armësh. Sipas KKZ-së, kjo nuk është e vërtetë, sepse po të kishte gjuajtje me armë, sigurisht që do të njoftoheshim nga organet e rendit, të cilët kanë qenë prezentë në këtë qendër të votimit. Andaj, në fund, KKZ i komunës së Hanit të Elezit deklaroi se procesi zgjedhor i mbajtur më dt. 12.10.2025 ka qenë i rregullt, i vëzhguar nga kamerat e vendosura në çdo vendvotim, po ashtu edhe nga vëzhguesit e subjekteve politike dhe të atyre ndërkombëtarë. Gjithashtu, ju njoftojmë se lidhur me rastin në fjalë, nuk është raportuar për ndonjë parregullsi në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, me datë 12.10.2025. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, janë dorëzuar nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë. Si dëshmi kanë ofruar përgjigjen e bashkangjitur të KKZ-së në komunën e Hanit të Elezit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës dhe KQZ-ja, vlerësoi se pretendimet në ankesë nga z.Rufki Suma kandidat i pavarur për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, të paraqitur kundër, mbështetësve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Hani i Elezit, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi gjatë ditës së votimit për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës me provat e bashkangjitura në ankesë nuk ka arritur të argumentoj pretendimet e tij lidhur me parregullsitë në ditën e zgjedhjeve. Paneli po ashtu edhe nga përgjigja e ofruar nga KQZ-ja -KKZ-ja e Komunës së Hanit të Elezit shihet se nuk ka pasur asnjë nga parregullsitë për të cilat pretendohen me ankesë.

Andaj Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se janë kryer shkeljet e pretenduara për të cilat iu referohet pala ankuese.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.225/2025 më datën 17.10.2025

Kryesuese e panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.